



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

VENDIM

K.P.P. 154/2020

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Evis Shurdha	Kryetar
Enkeleda Bega	Nënkryetar
Vilma Zhupaj	Anëtar
Lindita Skeja	Anëtar
Merita Zeqaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 29.04.2020, shqyrtoi ankesën me:

Objekt: Shfuqizimin e vendimit të KVO-së për skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Devis” sh.p.k., në procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur*”, me objekt “*Shërbimi i lavanderisë dhe hotelerisë në pavionet e Spitalit Universitar Obstetrik-Gjinekologjik “Koço Gliozheni”*”, me nr. REF-46140-12-13-2019, me fond limit 248,838,780 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 20.02.2020, nga autoriteti kontraktor, Agjencia e Blerjeve të Përqendruara.

Shtimin e arsyeve të skualifikimit të ofertës të paraqitur nga BOE “Balkan Laundry” sh.p.k. & “Neproma Service” s.r.l., në procedurën e prokurimit të sipërcituar.

Ankimues: Operatori ekonomik “Devis” sh.p.k.
Adresa: Rr. “Siri Kodra”, magazina nr.10, kati 1, pranë Uzinës Dinamo e Re, Tiranë.

Autoriteti Kontraktor: Agjencia e Blerjeve të Përqendruara
Adresa: Sheshi “Skënderbej”, nr. 3, Tiranë.

Baza Ligjore: *Ligji nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”.*

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës dhe të dokumentacionit të dërguar nga ankimuesi dhe autoriteti kontraktor, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se, mbështetur në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, ankimuesi ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.2. Ankimuesi ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe, më pas, ka paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e percaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”.

I.3. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës të operatorit ekonomik ankimues.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 16.12.2019, në sistemin e prokurimeve elektronike është publikuar procedura e prokurimit, “*Procedurë e hapur*”, me objekt “*Shërbimi i lavanderisë dhe hotelerisë në pavionet e Spitalit Universitar Obstetrik- Gjinekologjik “Koço Gliozheni”*”, me nr. REF-46140-12-13-2019, me fond limit 248,838,780 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 20.02.2020, nga autoriteti kontraktor, Agjencia e Blerjeve të Përqendruara.

II.2. Në datën 06.03.2020, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës, me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave ku rezulton si më poshtë vijon:

- | | |
|--|------------------------------------|
| 1. “Balkan Laundry” sh.p.k. & “Neproma Service” s.r.l. | 203,218,088 lekë, Skualifikuar; |
| 2. “Devis” sh.p.k. | 207,912,285 lekë, Skualifikuar; |
| 3. “Univers Servis” sh.p.k. | 217,152,831 lekë, Skualifikuar; |
| 4. “Gëzim Cara” sh.p.k. | 217,812,870 lekë, Skualifikuar; |
| 5. “Servizi Sanitari Integrali” s.r.l | 218,472,909 lekë, Skualifikuar; |
| 6. “AGS” sh.p.k. | 248,174,644 lekë, Skualifikuar; |
| 7. “Albania Distribution Chem” sh.p.k. | pa ofertë ekonomike, Skualifikuar; |
| 8. “W.Center” sh.p.k. | pa ofertë ekonomike, Skualifikuar; |

II.3.Me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorin ekonomik “Devis” sh.p.k. për skualifikimin e ofertës së tij, për procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi, me arsyetimin si më poshtë vijon:

“• Duke u bazuar në dokumentet e dorëzuara nga operatori ekonomik, për të provuar pasjen e numrit të punonjësve të kualifikuar, sipas profesioneve në tabelën e pikës 4, të kapacitetit Teknik në DT, ekzistencën e tyre në listëpagesat për periudhën e kërkuar korrik 2019 - dhjetor 2019 dhe pasjen e dokumentacionit përkatës për secilin punonjës sipas pikës së lartpërmendur, (kontrate pune, libeze pune, librezë shëndetsore), pas shqyrtimit e vlerësimit të përputhshmërisë së dokumenteve të dorëzuara me ato të kërkuara në dokumentat e tenderit, rezulton se ato nuk përputhen me kodet e profesioneve në listëpagesat për periudhën e kërkuar, bazuar në VKM nr.514 datë 20.09.2017 “Për miratimin e listës kombëtare të profesioneve”, pra ofertuesi nuk e përmbush kapacitetin teknik të kërkuar në DT. Konkretisht punonjësi znj. N.Z sipas dokumentacionit të paraqitur duhet të ishte punëtore ngarkim shkarkimi ndërkohë në listapagesat e paraqitura figuron punonjëse lavanderie. Përsonit të lartpërmendur i mungon libeza e punës. Gjithashtu nga dokumentacioni i paraqitur nuk figuron që të ketë magazinier”

II.4. Në datën 17.03.2020, operatori ekonomik “Devis” sh.p.k. ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor duke kundërshtuar vendimin e KVO-së për skualifikimin e ofertës së tij, si dhe ka kërkuar shtimin e arsyeve të skualifikimit të ofertës të paraqitur nga BOE “Balkan Laundry” sh.p.k. & “Neproma Service” s.r.l. në procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi, me argumentimin si më poshtë vijon:

“[...]Kjo arsye skualifikimi është e pa mbështetur në ligj, në rregullat e prokurimit publik, në kriteret e përcatkuara nga Autoriteti Kontraktor në DST përsa më poshtë sqarojmë:

Në DST, kriteret për kualifikim, kapaciteti teknik pika 4 është kërkuar:

Fuqia punëtore që kërkohet nga autoriteti kontraktor a) Operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin që vërteton se disponon personelin e nevojshëm për realizimin e kontratës si më poshtë vijon:

Nr	Personeli/Profilet e punës	Nr minimal i punonjësve
1	Punëtorë në Lavanderi	4
2	Punëtorë ngarkim shkarkimi	1
3	Punonjës shërbimi/Infermier i specializuar	4
4	Shofer/ Punonjës Mirembajtje	1
5	Magazinier	1
6	Pergjegjes sektori	1
TOTALI		12

b.Për punonjesit e në pozicionet e punës të përshkruara më sipër, operatori ekonomik duhet të paraqesë kontrata pune të vlefshme, librezat e tyre të punës si dhe librezat shëndetësore ku të vërtetohet se nuk janë mbartës të sëmundjeve infektive.

Nga Shoqeria jonë për të plotësuar këtë kriter ka paraqitur në SPE dokumentacionin si më poshtë : listpagesat sipas formularit E-sig për 93 punonjës Kontratat e punës, librezat e punes dhe librezat shendetesore per: Punëtorë në Lavanderi, 12 kontrata, 12 libeza shendetesore dhe 9 libeza pune. Punëtorë 1 kontrate, 1 libeze shendetesore dhe 1 libeze pune.

Punonjës shërbimi/Infermier i specializuar, 26 kontrata pune 26 libeza shendetesore dhe 6 libeza pune.

Shofer/ Punonjës Mirëmbajtje, 2 kontrata pune, 2 libeza shebdetesore dhe 2 libeza pune.

Pergjegjes sektori, 2 kontrata pune, 2 libreza shendetesore dhe 1 libeze pune.punes dhe librezat shendetesore .

Siç shihet kompania jone i tejkalon disa here kapacitetet per fuqi punetore te kerkuara ne dokumentat e tenderit. Komisioni i vleresimit te ofertave pretendon se shoqerija jone nuk disponon nje punetor ngarkim/shkarkimi dhe nje magazinier. Nga autoriteti kontraktor nuk jane kerkuar kodet e profesioneve ne listpagesave, pasi nese do te ish nje kriter i percaktuar ne dst, ne sistemin elektronik te tatimeve mund te kryheshin lehtesisht ndyshimet e kodeve kerkesave te vendosura nga autoriteti. Ne lidhje me disponimin e magazinierit sqarojme se procesi i punes se magazinierit nuk kerkon ndonje kualifikim te vecante dhe as është kërkuar nga AK në DST. Kete proces e kryejene punonjesit e sherbimit, keta punonjes jane te akomodurara ne pavionet e spitaleve te cilet dorezojne dhe e marrin me numer bazen materiale ashtu sic eshte e percaktuar dhe ne dokumetat e tenderit nga AK.

Menaxhimimi i Procesit te Lavanderise

Etapat e këtij procesi çdo ditë:

Çdo ditë K/infermierja e pavionit ose personi i autorizuar prej saj, përpilon, siglon dhe dorëzon, kërkesën (Fletë Forcën e Pavionit) për ditën e nesërme për material të butë, duke cilësuar numrin shtrimeve të reja, të cilën e dorëzon brënda orës 12:00 tek Sektori i sherbimeve, në drejtorinë e Spitalit Universitar Obstetrik Gjinekologjik “Koço Gliozheni” Tirane. Sektori i sherbimeve në Spitalin Universitar Obstetrik Gjinekologjik “Koço Gliozheni” Tirane, në bazë të kërkesave ditore (fletëve të forcave të pavionit) dhe grafikut të pavioneve, harton evidencën ditore përmbledhëse në shkallë Spitali, dhe ia dorëzon sipërmarrësit brënda orës 13:00 për ditën pasardhëse. Dorëzimi dhe numerimi i materialit të butë të larë, të thatë, të hekurosur, si dhe të paketuar do të bëhet çdo ditë në ambjentet që do caktohen nga Autoriteti Kontraktor në momentin e lidhjes së kontratës, çdo ditë në orën 07:00 nën prezencën e përfaqësuesit të autoritetit kontraktor dhe përfaqësuesit të sipërmarrësit, duke mbajtur proces-verbalin përkatës të firmosur nga palët. Ky dokument do ketë vlerë financiare, pasi likuidimi i operatorit ekonomikë do të bëhet mbi bazën e proces verbaleve të nënshkruara nga palët për çdo ditë.

Kriteret për kualifikim vendosen që ti shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të Operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asetë të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion realizimit me sukses të kontratës. Në kete kuptim për autoritetin kontraktor është e rëndësishme të provohet që operatori ekonomik zotëron kapacitetet (personelin) te kerkuara për realizimin e kontratës ne fjale, gjë e cila vërtetohet me se miri nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur nga ana jone. Nga verifikimi i dokumentave të tenderit, rezulton se në shtojcën 8, janë përcaktuar kriteret e përgjithshme dhe kriteret e veçanta për kualifikim, nga ku evidentohet të jetë përcaktuar vetëm kriteri që për punonjësit e kërkuar duhet paraqitur kontrata e punës dhe të figurojnë në listëpagesa dhe në asnjë rast nuk është përcaktuar ndonjë kërkesë në lidhje me faktin që në listëpagesa kodi i personelit të ketë të përcaktuar ndonjë kod në vecanti element i cili autoriteti kontraktor do të konsideronte të nevojshme për t’u paraqitur. Në rastin konkret, nga shqyrtimi i dokumentave të tenderit, rezulton se nga autoriteti kontraktor nuk është përcaktuar apo vendosur ndonjë kërkesë specifike në lidhje me kodin në listëpagesa, por është kërkuar thjesht paraqitja e kontratës së punës dhe këto punonjës të figurojnë në listëpagesa pa ndonjë përcaktim tjetër të veçantë apo specifik, ndaj arsyeja e skualifikimit të dhënë nga ana e AKsë nuk qëndron, dhe një kriter i pakërkuar në dokumentat e tenderit nuk duhet të përbëjë shkak për skualifikim. Autoriteti kontraktor duhet të bëjë vlerësimin e ofertave mbi bazën e kritereve të përcaktuara në dokumentat e tenderit, duke përjashtuar këtu vlerësimin mbi dokumenta/kritere shtesë të pakërkuara nga autoriteti kontraktor, të cilat për më tepër janë paraqitur nga OE

ankimues. Për pasojë, operatorët ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi duhet të plotësojnë vetëm kërkesat e vendosura në dokumentat e tenderit e, rrjedhimisht, vlerësimi e kualifikimi i tyre duhet të bëhet në përputhje vetëm me këto kërkesa. Në rastin konkret, në kushtet kur nga ana e autoritetit kontraktor nuk është kërkuar specifikisht elementi që duhet të përmbajë kodi i punonjësit në listëpagesa, përmbushja e specifikimeve teknike të kërkuara në dokumentat e tenderit provohet nëpërmjet dorëzimit të shtojcës 5 deklarate mbi përmbushjen e specifikimeve teknike, si edhe kontrata respektive dhe listëpagesave përkatëse.

Akoma më tej, edhe pse autoriteti kontraktor nuk ka përcaktuar ndonjë kriter specifik në lidhje mbi mënyrën se si duhet të paraqiteshin kontratat apo çfarë të dhënash duhet të përmbanin ato, në kontratat e paraqitura është pasqyruar drejt dhe qartë puna që do kryejë secili prej këtyre punonjësve. Sa më sipër, autoriteti kontraktor, duhet të udhëhiqet nga parimi i mirëpërdorimit të fondeve publike dhe përfitimi i një produkti me cilësi të mirë dhe me çmim më të ulët, si edhe nuk duhet të gjykojë në mënyrë sipërfaqësore e formale, aq më tepër në kushte kur kemi një përcaktim të qartë të kriterëve dhe dokumentacionit që duhet të paraqitet, dokumentacion ky i cili provohet më së miri se operatori ekonomik ankimues e disponon. Por akoma më tej sqarojmë se pretendimi i KVO-së është i pabazuar në dizpotat ligjore. Nuk ka asnjë parashikim ligjor për pretendimin e ngritur nga KVO. Si mund të përbëjë shkak për skualifikim një pretendim që nuk gjen mbështetje në asnjë dispozitë ligjore?!

Është e rëndësishme të sqarojmë se shoqëria DEVIS shpk, është një kompani e specializuar në fushën e lavanderisë industriale. Kompania e ka filluar aktivitetin e saj me pastrime kimike nderkohe që vazhdon aktivitetin e saj me një rritje të vazhdueshme sasiore e cilësore me shërbimin e lavanderisë industriale. Brenda pak vitesh, kompania ka hedhur hapat e mëdhenj drejt suksesit duke u bërë lider në tregun e lavanderisë, që vendos standard të larta në cilësi. Kompania është rritur shumë shpejt gjatë 17 viteve të fundit në përgjigje të kërkesës së shërbimit të lavanderisë dhe hotelerisë dhe tani është një nga kompanitë më të mëdha dhe e vetmja në vendin tonë. Kompania DEVIS është çertifikuar dhe vepron sipas Sistemit të Menaxhimit të Cilësisë sipas kërkesave të ISO 9001:2008, dhe certifikaten 14001:2004 sipas Sistemit të Menaxhimit të Mjedisit. Aktiviteti i kompanisë është i mbështetur nga personeli i kualifikuar prej 92 punonjësish. Kompania DEVIS ka një gamë të gjerë makinerish bashkëkohore në pronësi të saj. Gjatë këtyre viteve të aktivitetit të tij, në fushën e lavanderisë dhe hotelerisë kompania DEVIS Sh.p.k ka realizuar kontrata me institucione të ndryshme publike spitalore dhe jopublike vetëm për shërbim lavandierie dhe hotelerie.

Neni 1 i ligjit të prokurimit publik, qëllimi i procedurave të prokurimit publik, është të rrisë efikasitetin dhe etikitetin e përdorimit të parave publike, të nxisë pjesëmarrjen e operatoreve ekonomikë në procedurat e prokurimit dhe të nxisë konkurrencën, të sigurojë mirëpërdorimin e fondeve publike e të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedura prokurimi.

Vendimi i KVO-së është absolutisht i padrejtë dhe i bazuar në pretendime hipotetike dhe jo në fakte që ekzistojnë i cili na s'kualifikon pa asnjë arsye, në kundërshtim të hapur me rregullat e prokurimit publik. Kompania DEVIS ka plotësuar në mënyrë të përpiktë të gjitha dokumentat tekniko-ligjore, sipas të gjitha kërkesave të përgjithshme dhe të veçanta të kualifikimit të kërkuara nga Ak.

Akoma më tej kërkojmë shtimin e arsyeve të skualifikimit të operatorit tjetër ekonomik pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi e konkretisht Ballkan Landry i cili nuk plotëson kriteret si më poshtë:

1. Nuk plotëson piken 1 të Kapaciteti ekonomik dhe financiar: për xhiron e realizuar në tre vitet e fundit nga data e zhvillimit të procedurës, vlera mesatare e të cilës të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës së fondit limit. si dhe

2. Kapaciteti teknik: per realizimin e shërbimeve të meparshme, të ngjashme, te realizuara gjate 3 (tre) viteve te fundit nga data e zhvillimit te procedures, ne nje vlere jo me te vogel se 40 % e vleres se fondit limit. [...]"

II.5. Nga verifikimet e kryera në dokumentacionin e paraqitur pranë KPP, me anë të shkresës Nr. 530/3 Prot. datë 25.03.2020, autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje operatorit ekonomik ankimues "Devis" sh.p.k., duke mos e pranuar ankesën e paraqitur prej tij, me arsyetimin si më poshtë vijon:

"[...] Nga verifikimi në sistemin e prokurimit elektronik, ofertuesi ka dorëzuar listëpagesat, kontaktra, librezat shëndetësorë, librezat pune. Nga dokumentacioni i dorëzuar rezulton se ofertuesi ka dorëzuar më shumë kontrata nga sa janë kërkuar në kriterin e përcaktuar në pikën 4 në seksionin 4 në seksionin 3.2 "Kapaciteti teknik" në "Kriteret e Veçanta të Kualifikimit". Megjithatë për këta punonjës nuk janë të gjithë të pajisuar me librezat punë apo dhe me librezat shëndetësorë. Nga verifikimi rezulton se nuk ka asnjë kontrat punë për profesionin e kërkuar "magaziner", dhe rrjedhimisht nuk verifikohet as librezat e punës as dhe librezat shëndetësorë. Për punonjësen për të cilën operatori ekonomik e ka deklaruar në kontratë si "punonjëse ngarkim-shkarkimi" nuk figuron të këtë librezat punë të dorëzuar në sistemin e prokurimit elektronik. Për punonjësit e në pozicionet e punës të përshkruara më tabelën e pikës 4, operatori ekonomik duhet të paraqiste kontratat pune të vlefshme, librezat e tyre të punës si dhe librezat shëndetësorë ku të vërtetonte se nuk janë mbartës të sëmundjeve infektive.

Në lidhje më pretendimet e Ofertuesit për "Menaxhimimi i Procesit të Lavanderisë" për të shpjeguar mungesën e kontratës për "magaziner" sqarojmë se në rast se ofertuesi do të kishte paqartësi në lidhje mbi plotësimin e kërkesës së mësipërme, ka patur në dispozicion momentin procedural të paraqitjes së kërkesës për sqarime pranë autoritetit kontraktor e parashikuar nga neni 42 i LPP-së. Në nenin 42, pika 1 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar, parashikohet se "Ofertuesi i mundshëm mund të kërkojë sqarime për dokumentet e tenderit nga autoriteti kontraktor, i cili duhet t'i përgjigjet çdo kërkesë për sqarim të dokumenteve të tenderit, të bërë nga çdo operator ekonomik, me kusht që kërkesa të jetë marrë jo më vonë se 5 ditë para afatit përfundimtar të dorëzimit të ofertave. Autoriteti kontraktor duhet të përgjigjet brenda 3 ditëve nga depozitimi i kërkesës, në mënyrë që të bëjë të mundur dorëzimin e ofertës në kohë nga operatori ekonomik dhe, pa identifikuar burimin e kërkesës, duhet t'ia komunikojë sqarimin përkatës të gjithë operatorëve ekonomikë, që kanë tërhequr dokumentet e tenderit". Nëse ofertuesi do të kishte pretendime në lidhje me kriterin e vendosur në shtojcën nr. 8 atëherë duhet të kishte respektuar afatet e tij për ankim në bazë të paragrafit 1.1, të nenit 63, të ligjit nr. 9643 datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, ku parashikohet se: "Në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit, operatorët ekonomikë mund të ankohen pranë autoritetit kontraktor brenda 7 ditëve nga data e publikimit të njoftimit të kontratës në faqen në internet të Agjencisë së Prokurimit Publik..." si dhe të VKM-së nr.914 datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" e ndryshuar, neni 78, pika 4, në të cilin parashikohet se: "Në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit, operatorët ekonomikë mund të ankohen pranë autoritetit kontraktor brenda 7 (shtatë) ditëve nga data e publikimit të njoftimit të kontratës në faqen e internetit të APP-së..."

Për rrjedhim, në fazën e vlerësimit të ofertave Komisioni i Vlerësimit të Ofertave shqyrton dhe vlerëson dokumentacionin e paraqitur nga ofertuesi vetëm mbi kushtet dhe kriteret e përcaktuara në dokumentat e tenderit. Prandaj, mosplotësimi qoftë edhe i një kriteri të vendosur nga ana e autoritetit kontraktor e bën ofertën e operatorit ekonomik të pavlefshme. Ofertuesi ankimues duhej të dorëzonte të gjithë dokumentacionin e kërkuar në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit nga autoriteti kontraktor, në sistemin elektronik të prokurimeve. Operatori ekonomik është i detyruar të përgatisë ofertën, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në

dokumentat e tenderit, në mënyrë që edhe vlerësimi të bëhet në përputhje me këto kërkesa. Dokumentacioni i paraqitur nga ankimuesi në procedurën e prokurimit, nuk plotëson kushtet dhe kërkesat e autoritetit kontraktor, e si i tillë nuk mund të konsiderohet i vlefshëm. Për arsyet e më sipërme pretendimi i ofertuesit “Devis” SHPK nuk pranohet.

Lidhur me pretendimet e ankimuesit “Devis” SHPK, ku kërkon shtimin e arsyeve të skualifikimit të operatorit ekonomik “Ballkan Landry”, Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave gjykon se për sa kohë që ofertuesi “Ballkan Landry” është i skualifikuar, trajtimi i pretendimeve të ankimuesit, nuk ka ndikim mbi fatin e çështjes, pasi bazuar në legjislacionin në fuqi për prokurimin publik, interesi i ligjshëm i drejtpërdrejtë i ankimuesit, nuk ka sesi të dëmtohet. Pasi edhe në hipotezën që këto pretendime do të pranoheshin, nuk kanë asnjë ndikim në situatën e ofertuesit “Ballkan Landry”. Për këtë arsye këto pretendime nuk do të merren në shqyrtim [...]”

II.6.Në datën 27.03.2020, operatori ekonomik ankimues “Devis” sh.p.k., ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik, me të njëjtin objekt me ankesën e dorëzuar pranë autoritetit kontraktor, për procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi.

II.7.Në datën 10.04.2020, autoriteti kontraktor me anë të shkresës nr.581/1prot. datë 09.04.2020, ka dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik informacionin e kërkuar në lidhje me procedurën e prokurimit të sipërcituar.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, informacionit të autoritetit kontraktor dhe kërkesave të ankimuesit,

Arsyeton:

III.1.Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “Devis” sh.p.k. mbi skualifikimin e ofertës së tij, në procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi me arsyen : *“Duke u bazuar në dokumentet e dorëzuara nga operatori ekonomik, për të provuar pasjen e numrit të punonjësve të kualifikuar, sipas profesioneve në tabelën e pikës 4, të kapacitetit Teknik në DT, ekzistencën e tyre në listëpagesat për periudhën e kërkuar korrik 2019 - dhjetor 2019 dhe pasjen e dokumentacionit përkatës për secilin punonjës sipas pikës së lartpërmendur, (kontrate pune, libereze pune, libereze shëndetsore), pas shqyrtimit e vlerësimit të përputhshmërisë së dokumenteve të dorëzuara me ato të kërkuara në dokumentat e tenderit, rezulton se ato nuk përputhen me kodet e profesioneve në listëpagesat për periudhën e kërkuar, bazuar në VKM nr.514 datë 20.09.2017 “Për miratimin e listës kombëtare të profesioneve”, pra ofertuesi nuk e përmbush kapacitetin teknik të kërkuar në DT. Konkretisht punonjësi znj. N.Z sipas dokumentacionit të paraqitur duhet të ishte punëtorë ngarkim shkarkimi ndërkohë në listapagesat e paraqitura figuron punonjëse lavanderie. Përsonit të lartpërmendur i mungon libereza e punës. Gjithashtu nga dokumentacioni i paraqitur nuk figuron që të ketë magazinier”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:*

III.1.1.Në pikën 3.2.4 të shtojcës 8, “Kapaciteti teknik”, në dokumentat standarte të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi, autoriteti kontraktor ka kërkuar si më poshtë vijon:

I. “ Fuqia punëtorë që kërkohet nga autoriteti kontraktor”

a) *Operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin që vërteton se disponon personelin e nevojshëm për realizimin e kontratës si më poshtë vijon:*

<i>Nr</i>	<i>Personeli/Profilet e punës</i>	<i>Nr minimal i punonjësve</i>
1	<i>Punëtorë në Lavanderi</i>	4
2	<i>Punëtorë ngarkim shkarkimi</i>	1
3	<i>Punonjës shërbimi/Infermier i specializuar</i>	4
4	<i>Shofer/ Punonjës Mirembajtje</i>	1
5	<i>Magaznier</i>	1
6	<i>Pergjegjes sektori</i>	1
TOTALI		12

- a) *Për punonjesit e në pozicionet e punës të përshkruara më sipër, operatori ekonomik duhet të paraqesë kontrata pune të vlefshme, librezat e tyre të punës si dhe librezat shëndetësore ku të vërtetohet se nuk janë mbartës të sëmundjeve infektive.*
- b) *Punonjësit e mësipërm duhet të kenë të paktën 1 vit eksperiencë pune.”*

III.1.2. Me anë të shtojcës mbi modifikimin e dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi, autoriteti kontraktor ka ndryshuar kriterin e mësipërm si më poshtë:

“ **ISHTE:**

4. *Fuqia punëtore që kërkohet nga autoriteti kontraktor*

- b) *Operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin që vërteton se disponon personelin e nevojshëm për realizimin e kontratës si më poshtë vijon:*

<i>Nr</i>	<i>Personeli/Profilet e punës</i>	<i>Nr minimal i punonjësve</i>
1	<i>Punëtorë në Lavanderi</i>	4
2	<i>Punëtorë ngarkim shkarkimi</i>	1
3	<i>Punonjës shërbimi/Infermier i specializuar</i>	4
4	<i>Shofer/ Punonjës Mirembajtje</i>	1
5	<i>Magaznier</i>	1
6	<i>Pergjegjes sektori</i>	1
TOTALI		12

- c) *Për punonjesit e në pozicionet e punës të përshkruara më sipër, operatori ekonomik duhet të paraqesë kontrata pune të vlefshme, librezat e tyre të punës si dhe librezat shëndetësore ku të vërtetohet se nuk janë mbartës të sëmundjeve infektive.*
- d) *Punonjësit e mësipërm duhet të kenë të paktën 1 vit eksperiencë pune.*

BËHET:

4. *Fuqia punëtore që kërkohet nga autoriteti kontraktor*

- a) *Operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin që vërteton se disponon personelin e nevojshëm për realizimin e kontratës si më poshtë vijon:*

<i>Nr</i>	<i>Personeli/Profilet e punës</i>	<i>Nr minimal i punonjësve</i>
1	<i>Punëtorë në Lavanderi</i>	4
2	<i>Punëtorë ngarkim shkarkimi</i>	1
3	<i>Punonjës shërbimi/Infermier i specializuar</i>	4
4	<i>Shofer/ Punonjës Mirembajtje</i>	1
5	<i>Magaznier</i>	1
6	<i>Pergjegjes sektori</i>	1
TOTALI		12

Për punonjësit e në pozicionet e punës të përshkruara më sipër, operatori ekonomik duhet të paraqesë kontrata pune të vlefshme, librezat e tyre të punës si dhe librezat shëndetësorë ku të vërtetohet se nuk janë mbartës të sëmundjeve infektive.”

III.1.4. Në nenin 46, pika 1 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: *“Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese.”* Ndërsa në nenin 53/3 të LPP-së përcakohet se: *“Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një oferte të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit.”*

III.1.5. Neni 28, pika 5, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, parashikon shprehimisht se : *“Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti kontraktor kërkon:*

- a) licencat profesionale për realizimin e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe /ose*
- b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla; dhe/ose*
- c) dëshmi për fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose*
- ç) dëshmi për mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.*
- d) Në rastin e procedurës së prokurimit “Shërbim konsulence”, stafi i angazhuar të paraqesë deklaratë disponueshmërie për kryerjen e shërbimeve që ka marrë përsipër të realizojë.”*

III.1.6. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike në përmbushje të kriterëve të sipërcituar, operatori ekonomik ankimes, “Devis” sh.p.k ka paraqitur një sërë dokumentacioni lidhur me fuqinë punëtore, të cilin do e vërë në dispozicion për zbatimin e kontratës objekt prokurimi. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërituar, KPP konstaton se operatori ekonomik “Devis” sh.p.k. nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion provues lidhur me disponueshmërinë e punonjësit «Magazinier» sikurse është kërkuar në mënyrë shteruese nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit, si dhe nuk figuron asnjë punonjës në listëpagesat e shoqërisë, me kodin që i korrespondon profesionit të magazinierit 4321.01. Gjithashtu, konstatohet se është paraqitur dokumentacion lidhur me punonjësin për ngarkim-shkarkim, kontratë pune e N.Z., por nuk është paraqitur librezë pune për këtë të fundit, në kundërshtim me përcaktimet e autoritetit kontraktor në dokumentat e tenderit, si dhe nuk figuron e punësuar me kodin 9333, që i përket profesionit të ngarkim-shkarkimit, në listëpagesat e shoqërisë. KPP gjykon se operatori ekonomik ankimes nuk i ka përmbushur kërkesat në pikën 3.2.4 të shtojcës 8, “Kapaciteti teknik”, në dokumentat standarte të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi, pasi nuk ka dorëzuar dokumentacionin e kërkuar për përmbushjen e këtij kriteri. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t’i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në

funkcion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Në rast se operatorët ekonomik nuk plotësojnë qoftë edhe një kërkesë të vetme sipas përcaktimeve të autoritetit kontraktor në dokumentat e tenderit, ofertat e tyre duhet të refuzohen si të papranueshme.

III.1.7. Në rast se operatori ekonomik ankimues "Devis" sh.p.k do të kishte pretendime në lidhje me kërkesën e mësipërme të autoritetit kontraktor, ka patur në dispozicion momentin procedural të paraqitjes së ankesës mbi hartimin e dokumenteve dhe kritereve të veçanta të kualifikimit të procedurës së prokurimit objekt ankimi, parashikuar nga neni 63 pika 1/1 e LPP. Në nenin 63 pika 1/1 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar parashikohet se "Në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit, operatorët ekonomikë mund të ankohen pranë autoritetit kontraktor brenda 7 ditëve nga data e publikimit të njoftimit të kontratës në faqen në internet të Agjencisë së Prokurimit Publik. Me marrjen e ankesës me shkrim, autoriteti kontraktor pezullon vazhdimin e procedurës së prokurimit, derisa ankesa të jetë shqyrtuar plotësisht, përfshirë dhe nxjerrjen e një vendimi brenda 3 ditëve nga data e depozitimit të ankesës. Ndaj vendimit përfundimtar të autoritetit kontraktor mund të bëhet ankim në Komisionin e Prokurimit Publik, në përputhje me pikën 6 e në vijim të këtij neni". Gjithashtu, kuadri ligjor parashikon një sërë elementësh si garanci për operatorët ekonomikë të cilët kanë paqartësi në lidhje me interpretimin e kërkesave të autoritetit kontraktor dhe/ose mënyrës së plotësimit të kritereve kualifikuese. Në rast se operatori ekonomik ankimues do të kishte paqartësi në lidhje mbi plotësimin e kërkesës së mësipërme, ka në dispozicion momentin procedural të paraqitjes së kërkesës për sqarime pranë autoritetit kontraktor deri në pesë ditë para dorëzimit të ofertave parashikuar nga neni 42 i LPP-së. Në nenin 42, pika 1 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar, parashikohet se "[...] Ofertuesi i mundshëm mund të kërkojë sqarime për dokumentet e tenderit nga autoriteti kontraktor, i cili duhet t'i përgjigjet çdo kërkesë për sqarim të dokumenteve të tenderit, të bërë nga çdo operator ekonomik, me kusht që kërkesa të jetë marrë jo më vonë se 5 ditë para afatit përfundimtar të dorëzimit të ofertave. Autoriteti kontraktor duhet të përgjigjet brenda 3 ditëve nga depozitimi i kërkesës, në mënyrë që të bëjë të mundur dorëzimin e ofertës në kohë nga operatori ekonomik dhe, pa identifikuar burimin e kërkesës, duhet t'ia komunikojë sqarimin përkatës të gjithë operatorëve ekonomikë, që kanë tërhequr dokumentet e tenderit [...]"

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik "Devis" sh.p.k. nuk qëndron.

III.2. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik "Devis" sh.p.k. mbi shtimin e arsyeve të skualifikimit të ofertës të paraqitur nga BOE "Balkan Laundry" sh.p.k. & "Neproma Service" s.r.l., Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se, fati i këtij bashkimi operatorësh ekonomik është përcaktuar tashmë prej vendimit të KVO-së të datës 06.03.2020, ku ky bashkim rezultoi i skualifikuar nga kjo procedurë prokurimi, e për rrjedhojë pa asnjë ndikim në interesat e ankimuesit. Për më tepër, nga verifikimi i informacionit të paraqitur nga autoriteti kontraktor, si dhe nga shqyrtimi administrativ në KPP, nuk rezultoi që ky bashkimi operatorësh ekonomik të jetë ankimuar në lidhje me këtë procedurë prokurimi.

Rrjedhimisht, pretendimi i operatorit ekonomik "Devis" sh.p.k. mbi shoqërinë BOE "Balkan Laundry" sh.p.k. & "Neproma Service" s.r.l. nuk do të merret në shqyrtim.

Për sa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, nenit 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri

Vendos:

1. Të mos pranojë ankesën e operatorit ekonomik “Devis” sh.p.k., për procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur*”, me objekt “*Shërbimi i lavanderisë dhe hotelerisë në pavionet e Spitalit Universitar Obstetrik- Gjinekologjik “Koço Gliozheni”*”, me nr. REF-46140-12-13-2019, me fond limit 248,838,780 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 20.02.2020, nga autoriteti kontraktor, Agjencia e Blerjeve të Përqendruara.
2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.
3. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.
4. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr. 325 protokoli Datë 27.03.2020;

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Enkeleda Bega

Anëtar
Vilma Zhupaj

Anëtar
Lindita Skeja

Anëtar
Merita Zeqaj

Kryetar
Evis Shurdha